

VENDIM

Nr. 19, Datë 26.06.2012

PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË DETYRUESHËM TË GJUHËS ANGLEZE DHE TË TESTEVE TË GJUHËS ANGLEZE PËR STUDENTËT QË DIPLOMOHEN NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Senati Akademik i Universitetit të Arteve në mbledhjen e datës 26.06.2012, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur, vlerësoi propozimet e dhëna nga Fakultetet e Universitetit të Arteve me shkresat nr. 784 prot., datë 12.06.2012, nr. 778/1 prot., datë 11.06.2012 dhe nr. 778 prot., datë 11.06.2012, si dhe shkresës së Këshillit Studentor me nr. 767 prot., datë 07.06.2012, pas diskutimeve të anëtarëve dhe propozimeve përkatëse, bazuar në nenin 26 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 si dhe Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës me nr. 14, datë 28.03.2011 "Për njohjen e testeve dhe certifikimeve për gjuhën angleze për programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në Institucionet e Arsimit të Lartë";

VENDOSI

1. Miratimin e nivelit A1 të gjuhës angleze sipas testeve të njohura ndërkombëtarisht, si nivel i detyrueshëm për studentët, për përfundimin e studimeve në programet e studimit të ciklit të dytë në Universitetin e Arteve. Përshkrimi i nivelit A1 është sipas Shtojcës 2 të Udhëzimit nr. 14, datë 28.03.2011 "Për njohjen e testeve dhe certifikimeve për gjuhën angleze për programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në Institucionet e Arsimit të Lartë", të MASH;
2. Testimi për njohuritë në gjuhën angleze do të kryhet para përfundimit të ciklit të dytë të studimeve.
3. Testet e vlefshme do të konsiderohen testet përcaktuara në Shtojcën 1 të Udhëzimit nr. 14, datë 28.03.2011 "Për njohjen e testeve dhe certifikimeve për gjuhën angleze për programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë në Institucionet e Arsimit të Lartë", të MASH si dhe ato që do të konfirmohen nga MASH:
 - Cambridge ESOL – University of Cambridge Examinations;
 - IELTS – International English Language Testing System;
 - TOEFL – Test of English as a Foreign Language;

- TOEIC - Test of English for Internatinal Communication;
- Michigan-Test;
- PTE General – Pearson Test of English General

4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE